



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE  
KAPITENERIA E PORTIT VLORË

Nr. \_extra\_ prot.

Vlorë, më \_15\_01\_2021

Lënda : Analiza për Janar-Dhjetor 2020 në Kapitenerinë e Portit Vlorë

**DREJTORISË PËRGJITHSHME DETARE**

➤ **Objektivat e realizuara nga Kapiteneria e Portit Vlorë**

1. Kapiteneria e Portit Vlorë ka kryer Monitorimin e Trafikut Detar në portin e Vlorës, terminalin PIA dhe në gjiun e Vlorës 24orë/7ditë.  
Për sezonin turistik veror 2020 ka kryer inspektimin për marjen e masave dhe sigurinë në plazhe sëbashku me task-forcën e krijuar për këtë qëllim të cilën ka marrë pjesë në shumë takime të ndryshme të krijuara nga Prefekti Qarkut Vlorë, Ministri të ndryshme dhe institucione të tjera.
2. Ka kryer monitorimin nga afër të mjeteve turistike +12pasagjer që nisen nga porti i Vlorës, Triport dhe Radhimë përfshirë Marina Orikum.
3. Ka kryer inspektime të ndryshme për plotësimin e standarteve të mjeteve turistike +12pasagjer me grupet e punës të ngritur nga Drejtoria e Përgjithshme Detare Durrës.  
Ka marrë pjesë në shumë situata të ndryshme detare të cilat kanë qënë nën juridiksionin e saj.
4. Ka pasur bashkëpunim shumë të mirë me Rojen Bregdetare, Policinë Kufitare dhe autoritetet e tjera portuale për situata të ndryshme detare dhe portuale.
5. Ka kryer kontrollin e mjeteve lundruese me flamur Shqiptar dhe të huaj në nisje-mbërritje sipas konventës FAL.

➤ **Situata të ndryshme të ndodhura për periudhën Janar-Dhjetor 2020**

1. 1 (një) 05.08.2020 situatë mbytje totale anije peshkimit (flug) në Himarë (1 viktim)
2. 1 (një) 20.08.2020 situatë rënie zjarri në bord të mjeti të vogël turistik djegie pjesërisht, treport (pa viktima)
3. Shumë situata të ndryshme për dhënie asistence të mjeteve të vogla lundruese të cilat kanë pasur avari në motor me flamur të huaj dhe flamur shqiptar në bashkëpunim me policinë Kufitare dhe Rojen Bregdetare.

➤ **Situata dhe masat e marra për parandalimin e virusit "COVID-19"**

Në bazë të situatës aktuale në vendin tonë në lidhje me masat e marra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 Kapiteneria e Portit Vlorë ka zbatuar të gjitha urdhërat e Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe ka marrë këto masa parandaluese si më poshtë :

1. Njoftimin e gjithë institucioneve portuale të portit detar Sh.a Vlorë në vazhdimësi në lidhje me kufizimet e ndryshme sipas urdhërave dhe udhëzimeve të Drejtorisë së Përgjithshme Detare.
2. Zbatimi me rigorozitet i protokolleve dhe udhëzimeve mjeksore në ambientet e Kapitenerisë Vlorë.  
Për vitin - 2020 kemi patur dy raste me Covid-19 ku ndaj tyre dhe punonjësve të tjerë të cilët kishin pasur kontakt me personat e infektuar në Kapitenerisë Portit Vlorë u zbatuan gjithë masat dhe udhëzimet e nevojshme mjeksore në përputhje me protokollet dhe udhëzimet nga Spitali Rajonal Vlorë.

➤ **Kapiteneria e Portit Vlorë për periudhën Janar-Dhjetor 2020 ka vënë re këto problematika :**

**Problematika të brendshme :**

1. Ambientet e punës zyrtar, muret janë të plasaritura dhe janë të amortizuara
2. Ambientet e punës dhe orenditë janë të amortizuara (janë të sajuara dhe mirëmbajtur nga vetë inspektorët)
3. Paisjet e komunikimit dhe navigacionale kanë nevojë për mirëmbajtje vjetore

➤ **PROBLEMATIKA TË PËRGJITHSHME PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2020 :**

1. Udhëzimet e reja për mjetet turistike deri 12pasagj. / mbi 12 pasagjer , kërkesat, ndryshimet, kodi detar.
2. Kontrolli i kapacitetit të anijeve turistike (duhet gjetur një mënyrë e përshtatshme për ti kontrolluar)
3. Rishikimi i udhëzimit për ekuipazhimin e anijeve turistike +12pasagjer.
4. Përcaktimi dhe plotësimi i kërkesave të anijeve turistike duhet bërë përpara fillimit të sezonit
5. Auditimi i anijeve turistike duhet bërë nga DPD-ja përpara se të marin certifikatën vjetore të R.SH
6. Anijet Turistike që vijnë në Shqipëri për herë të parë duhet të kenë të kryer dokimin brenda vitit.
7. Anijet turistike duhet të paisjen me LIÇENSE nga QKB për ushtrimin e këtij aktiviteti sipas kërkesave të përcaktuara nga DPD-ja me kodin përkatës VII.4.1 ose një kodë tjetër pranë QKB-së.
8. Menaxhimi më i mirë i mbetjeve të ngurta dhe vajore të anijeve turistike (udhëzim të bëhet e detyrueshme)
9. Kontrolli më i detajuar nga K.SH.F-ja ose K.SH.P për kërkesat për mjetet dhe paisjet e anijeve turistike.
10. Mjetet e vogla lundruese turistike si gomone, jahte me flamur të huaj duhen kontrolluar për ushtrimin e aktivitetit në Republikën e Shqipërisë pasi është i ndaluar sipas Kodit Detar Shqiptar
11. Mjetet e vogla lundruese turistike si gomone, jahte me flamur të huaj nuk flasin në radio kur hyjnë në gjiun e Vlorës, të cilat duhet të marin info nga kapiteneritë dhe portet e brendshme Shqiptare.

12. Rishikimi i udhëzimit për mjetet e vogla lundruese turistike si gomone, jahte me flamur të huaj që vijnë nga portet e huaja dhe ato të brendshme
13. Rregullorja e Kapitenerisë
14. Experti detar dhe paisja me LICËNSE nga QKB për ushtrimin e këtij aktiviteti sipas kërkesave të përcaktuara nga DPD-ja duke krijuar kodin përkatës VII.5.5/1 në QKB.
15. Rishikimi i udhëzimit për rinovimin e dëshmive të drejtuesve me mjete lundruese peshkim.
16. Unifikimi dhe përditësimi me format (leje-nisje, fatura, mandatet etj) të Kapitenerisë në R.SH
17. Unifikimi dhe përditësimi i rregjistrave (nisje, mbërritje, peshkimi, nafte etj ) të Kapitenerisë në R.SH
18. Unifikimi i regjistrimit për mjetet e vogla dhe anijet e peshkimit.

Lorenc REXHEPAJ  
KAPITENI I PORTIT VLORE

